

BULETIN NR.2



SHOQATA RYDER ALBANIA

Adresa: Rr.Vllazën Huta,Nd 90,H4

Email: info@ryderalbania.org

Tel: 0035542452309

Website: www.ryderalbania.org.al

Kujdesi dhe shërbimet
shëndetësore për të
moshuarit në Tiranë



BASHKIA
TIRANË

Sue Ryder Care
Albania



Financuar nga
Bashkimi Evropian



Ky publikim është realizuar nga Shoqata Ryder Albania në kuadër të Projektit "Ofrimi i shërbimit të kujdesit në banesë për të moshuarit, në Tiranë" në partneritet me Bashkinë Tiranë dhe financuar nga Bashkimi Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e autorëve realizues dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

Të dashur lexues!

Ju përshëndesim në këtë edicion special të buletinit tonë, të krijuar posaçërisht për të moshuarit. Ky buletin synon të trajtojë dhe të sjellë në vëmendje tema të rëndësishme që prekin jetën tuaj të përditshme, duke ju ndihmuar të përballeni me sfidat që vijnë me kalimin e moshës.

Në këtë buletin, ne do të ndajmë me ju informacione të rëndësishme dhe të dobishme rreth shërbimeve shëndetësore që ofrohen nga qendrat shëndetësore, me një fokus të veçantë në nevojat e të moshuarve. Ne jemi të përkushtuar t'ju ofrojmë një udhëzues të qartë dhe të detajuar, që shpalos hollësitë e sistemit të kujdesit shëndetësor, tregon mënyrat se si mund të përfitoni maksimalisht nga të drejtat dhe shërbimet e ofruara, dhe ndihmon në ndërtimin e një marrëdhënieje të shëndoshë me profesionistët e shëndetësisë.

- Së fundmi, do të theksojmë rëndësinë vitale të njohjes dhe përdorimit të numrave të emergjencave, për çdo rast të papritur. Këto informacione synojnë t'ju japin siguri dhe qetësi në çdo moment.
- Ne shpresojmë që ky buletin të jetë një burim i çmuar për ju.

Me respekt,
Shoqata Ryder Albania



Shërbimet dhe struktura e qendrave shëndetësore:

Qendra shëndetësore vepron nëpërmjet një rrjeti ambulancash dhe qendrash shëndetësore të shpërndara afër komuniteteve, duke u mundësuar qasjen në kujdesin shëndetësor edhe në zonat më të largëta.

Stafi i qendrave shëndetësore përfshin një ekip të përbërë nga mjekë, infermierë, mami, punonjës socialë dhe/ose psikologë dhe personel mbështetës që punojnë së bashku për të ofruar një shërbim cilësor dhe të personalizuar.

Qendra shëndetësore i shërben mesatarisht një popullatë prej 8,000-10,000 personash, duke patur një raport mjek/pacient rreth 1 me 2500 dhe raport infermiere/pacient rreth 1 me 400 banorë.

Orari dhe tarifat e shërbimeve:

Çdo qendër shëndetësore dhe ambulancë ofron një orar të qartë të funksionimit dhe një listë të tarifave për ekzaminimet me pagesë për individët e pasiguruar, duke i bërë këto informacione të lehtë për t'u ndjekur nga të moshuarit.

Qendrat shëndetësore në Tiranë ofrojnë shërbim nga ora **08.00 - 20.00** nga e hëna në të shtunë



Përqendrimi në nevojat e të moshuarve:

Qendra shëndetësore duhet të kenë një angazhim të veçantë ndaj të moshuarve në komunitet, duke ofruar shërbime të personalizuar që përfshijnë kujdesin mjekësor, mbështetjen emocionale dhe ndihmën në përdorimin e shërbimeve të ndryshme shëndetësore.



Të drejtat dhe përgjegjësitë e pacientit

Të drejtat e pacientit:

- Të ketë qasje në shërbime shëndetësore.
- Të ketë privatësi dhe besueshmëri.
- Të informohet mbi gjendjen e tij shëndetësore.
- Të dërgohet tek një mjek më i specializuar, nëse ka nevojë.
- Të zgjedhë mjekun e familjes një herë në vit.
- Të ketë kujdes të vazhdueshëm shëndetësor.
- Të marrë pjesë në vendimet për shëndetin e tij.
- Të trajtohet nga mjekë dhe infermierë të kualifikuar.
- Të refuzojë trajtimin mjekësor, nëse dëshiron.
- Të informohet për skemën e sigurimit shëndetësor.
- Të ankohet nëse nuk është i kënaqur me shërbimin shëndetësor.

Përgjegjësitë e pacientit:



- Të jetojë një jetë të shëndetshme.
- Të ruajë mjedisin ku jeton.
- Të respektojë të drejtat e pacientëve të tjerë dhe të stafit mjekësor.
- Të përdorë sistemin shëndetësor në mënyrën më të mirë dhe të mos abuzojë me të.
- Të njohë shërbimet shëndetësore që i ofrohen.
- Të japë informacion të saktë mjekëve për diagnozën dhe trajtimin e tij.
- Të marrë këshilla dhe të pranojë trajtimet mjekësore dhe riaftësimin fizik.
- Të dijë për koston dhe mënyrën e pagesës së shërbimeve shëndetësore.
- Të kujdeset për kartelën shëndetësore ose kartën e sigurimit shëndetësor.



Të moshuarit në sistemin e kujdesit shëndetësor

- Nëse keni një problem shëndetësor, duhet të vizitoni fillimisht mjekun tuaj të familjes pranë qendrës shëndetësore ku jeni të regjistruar. Ky kontakt është hapi i parë në procesin e kujdesit shëndetësor dhe funksionon bazuar në sistemin e referimit.
- Kujdesi shëndetësor për të moshuarit mbi 65 vjeç përfshin shërbime të veçanta, përfshirë parandalimin e komplikacioneve të sëmundjeve kronike dhe promovimin e një stili jetese të shëndetshme.

- Është e rëndësishme të keni kartën tuaj të shëndetit. Kjo kartë është e domosdoshme për të përfituar nga shërbimet shëndetësore falas.
- Aplikimi, gjenerimi dhe rinovimi i kartës mund të bëhet online nëpërmjet platformës e-Albania.
- Nëse nuk mundeni të përdorni platformën e-Albania ju lutemi drejtojuni stafit të projektit që t'ju ndihmojë.
- Nëse mjeku juaj i familjes rekomandon një kujdes më të specializuar, do t'ju udhëzojë tek një mjek specialist në poliklinikën e specialiteteve.
- Kur vizitoni një mjek specialist për konsulta apo ekzaminime në poliklinikën e specialiteteve, duhet të keni me vete rekomandimin nga mjeku i familjes, kartën e shëndetit dhe një dokument identifikimi.
- Mjeku specialist mund t'ju kërkojë ekzaminime shtesë, të cilat janë falas nëse keni ndjekur sistemin e referimit. Të moshuarit përfitojnë falas vizita, ekzaminime, trajtime dhe receta të rimbursueshme, vetëm nëse zbatohet sistemi i referimit.
- Shërbimi i Kujdesit Shëndetësor Dytësor dhe Terciar (QSUT; Shërbimet Ndërkohë; Spitali Ushtarak; dy maternitetet): Ky shërbim përfshin kujdesin e nevojshëm që nuk mund të ofrohet nga kujdesi parësor dhe është i disponueshëm në qendra të veçanta shëndetësore. Edhe në këtë rast ju nevojitet rekomandimi nga mjeku i familjes, karta e shëndetit dhe dokument identifikimi.
- Në raste urgjence, mund të telefononi në numrin falas **127**. Ky shërbim ofron kujdes klinik dhe paraspitalor në situata rreziku për jetën.

Çfarë është kontrolli periodik?



- Nëse nuk e keni bërë ende kontrollin shëndetësor falas, duhet të kontaktoni me mjekun e familjes, i cili ju drejton pranë qendrës shëndetësore që ju takon për të bërë kontrollin.
- Me rekomandimin e mjekut të familjes duhet të paraqiteni në qendrën shëndetësore ku bëhet kontrolli, për të lënë një ditë të caktuar, orarin si edhe për të marrë dy kontenitorë (shishe të vogla) për analizat.
- Ju duhet të merrni një rekomandim nga mjeku i familjes dhe me atë letër duhet të caktoni një ditë e orar, të favorshëm për ju. Ditën e analizave, duhet të shkoni në orarin e caktuar, duhet të jeni esëll dhe të keni me vete një mjet identifikimi.
- Në qendrën shëndetësore, ku do të kryeni **Check-Up**, paraprakisht dorëzoni kontenitorët, më pas ju merren të dhënat dhe infermierët ju bëjnë matjet e parametrave truporë. Për të vazhduar më pas me pyetësin, mbi mënyrën e ushqyerjes dhe shëndetit mendor.
- Pasi mbarohet plotësimi i pyetësit, bëhet **EKG**. Në fund, merret gjaku. Të dhënat tuaja dhe analizat dërgohen në laborator për t'u ekzaminuar.
- Pasi mbaroni procedurën e kontrollit në qendrën shëndetësore, përgjigjet e analizave i merrni pas dy javësh. Është mjeku i familjes i cili ju komunikon rezultatet.
- Orari i disponueshëm për kryerjen e kontrollit është **8:00** e mëngjesit me **12:00** të drekës. Koha e nevojshme për çdo person llogaritet 30 minuta.
- Të dhënat dërgohen në laborator, bashkë me analizat, më pas përgjigjet i dërgohen mjekut të familjes, i cili jua interpreton.